



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 243, datë 21.12.2020

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ES 2019” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 8, pika 3, neni 9, pikat 1,2,3, pika 4,8, nenit 10, pika 1 dhe 3 të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/13 Prot., datë 17.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ES 2019” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “ES 2019” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1239 Prot., datë 02.12.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “ES 2019” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si më poshtë:
 - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**
Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, plotësuar.
 - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal**
Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “d”, plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor**

Neni 9, pika 2

- **germat “a”/“b”** (akti i themelimit/statuti (nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/ i veçantë nga akti i themelimit)). **Plotësuar pjesërisht.**
Shoqëria duhet të depozitojë në ERE Aktin e Themelimit të nënshkruar nga themeluesi (origjinal ose fotokopje e noterizuar), si dhe Statutin në formatin origjinal ose fotokopje e noterizuar.
- **germa “c”** (vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)). **Plotësuar pjesërisht.**
-Shoqëria duhet të depozitojë në ERE certifikatën e regjistrimit.
- **germa “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). **Plotësuar pjesërisht.**
- **germa “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). **Pa plotësuar.**
-Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

➤ **Dokumentacioni financiar dhe fiskal,**

Neni 9, pika 3

- **germa “b”** (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera, paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). **Pa plotësuar.**
-Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.
- **germa “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.) **Pa plotësuar.**
-Shoqëria nuk ka depozituar në ERE dokumentacionin që kërkohet nga kjo pikë e rregullores.

➤ **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike,**

Neni 9, pika 4.8

- **gërmat “a”** (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh sipas viteve); **Plotësuar pjesërisht.**
-Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, shoqëria ka deklaruar volumin e tregtimit të energjisë për një vit, ndaj duhet të saktësojë sasinë e energjisë që parashikon edhe për 4 vitet e tjera.
- **germa “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.) **Pa plotësuar.**
-Shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- **germa “c”** (Lista e kontratave të mëparshme të realizuara (nëse ka patur)). **Pa plotësuar**
-Shoqëria nuk ka depozituar informacion qoftë edhe në mënyrë deklarative në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.
- Në bazë të nenit 11, pika 1 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, do të njoftohet subjekti t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI